



KOSOVË REPUBLIC OF KOSOVO	
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS	
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA	
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO	
Zyra për Propozime dhe Përcaktim të Kanaleve të Propozimeve i Predstavke Table Office	
Propozim No 06/1365/10-762	Data 23.05.2018
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA	


**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

<b>PËR / ZA / TO</b>	z. Skënder Reçica Ministër - i Punës dhe Mirëqenies Sociale	<b>DATE DATUM DATE</b>	23.05.2018
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Haxhi Avdyli – Deputet i Grupit Parlamentar të LDK-së		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje Parlamentare		

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës së Kuvendit të Kosovës.

**Çështja:** Komisioni mjekësor për riverifikimin e shkallës së paaftësisë së invalidëve të luftës.

**Pyetja:** Ka raportime që komisioni për riverifikimin e shkallës së paaftësisë së invalidëve të luftës etj. i është nënshtruar presioneve nga jashtë, nga grupe të ndryshëm politike e partiake, për të mos rrezuar shkallën e invaliditetit të personave të paraqitur rrejtshëm si invalid. Pse po zvogëlohet pagesa e këtij komisioni dhe pse s'po paguhen anëtarët e saj a është kjo një presion shtesë për të shtyre ata për tërheqje nga ky komision.




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

<b>PËR / ZA / TO</b>	Uran Ismaili- Ministër i Shëndetësisë	<b>DATE DATU M</b>	12.06.2018
		<b>DATE Reference</b>	
	Haxhi Avdyli - Deputet i Grupit Parlamentar të LDK-së		
<b>SUBJE KTI PRED MET SUBJE CT</b>	Pyetje parlamentare për përgjigje me gojë		

Në bazë të Nenit 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

**Çështja: Ligji për shëndetësi** si ligji bazik i shëndetësisë është paraparë në strategjinë legjislative 2018 se do sjellët për plotësim ndryshim. Duke parë nevojën për reformën e sektorit shëndetësor e cila duhet te behet përmes këtij ligji deri me tani nuk kemi parë një lëvizje nga ana M.Sh dhe juaj për sjelljen e këtij ligji ne komision dhe mekanizma tjerë për diskutim dhe vërejtje

**PYETJA:** Çfarë po ndodh me këtë proces? Deri ku keni arrit me harmonizimin e ndryshimeve te këtij ligji? Kur planifikohet dhe cilat janë ndryshimet e parapare nga ana juaj për plotësim ndryshimin e këtij ligji?




Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	<i>z. Shyqiri Bytyqi, Ministër – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë</i>	<b>DATE DATUM DATE</b>	11.07.2018
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	<i>Valentina Bunjaku – Rexhepi, Deputete e Grupit Parlamentar të LDK-së</i>		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	<i>Pyetje Parlamentare</i>	<i>Shyqiri</i>	

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës së Kuvendit të Kosovës.

Çështja: *Ri-regjistrimi i Agjencisë së Kosovës për Akreditim pas përjashtimit nga EQAR.*

**Pyetja parlamentare:** Z. Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, është bërë tashmë e njohur se Kosova do të duhej të priste edhe 90 ditë apo 3 muaj për fillimin e procedurave të ri-regjistrimit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) në Regjistrin Evropian për Cilësi të Arsimit të Lartë (EQAR). A është ri-regjistruar akoma AKA në EQAR, pas skandalit që e prodhoi ndërhyrja politike e Qeverisë suaj në AKA?



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly


<b>PËR / ZA / TO</b>	<i>z. Shyqiri Bytyqi, Ministër – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë</i>	<b>DATE DATUM DATE</b>	11.07.2018
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	<i>Valentina Bunjaku – Rexhepi, Deputete e Grupit Parlamentar të LDK-së</i>		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	<i>Pyetje Parlamentare</i>		

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës së Kuvendit të Kosovës.

**Çështja:** Vazhdimi i pagesës së rregullt për mësimdhënësit me diagnostifikim të kancerit.

**Pyetja parlamentare:** z. Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, çfarë po bëhet nga ministria që e drejtoni ju, për mësimdhënësit me diagnostifikim të kancerit, si dhe a do të bëhet vazhdimi i pagesës së rregullt dhe të plotë për ta, që në momentin e diagnostifikimit zyrtar me kancer nga mjekët dhe të mos kushtëzohen pagat e tyre të punojnë në këtë gjendje të rëndë shëndetësore?






**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

<b>PËR / ZA / TO</b>	Z.Skendes Reçica , Ministër i Punës dhe mirëqenies Sociale	<b>DATE DATUM DATE</b>	13 korrik 2018
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Rasim Selmanaj, Deputet, Grupi Parlamentar i AAK-së		
<b>SUBJEKTI PREDMET T SUBJECT</b>	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45.2 të Rregullorës së Punës së Kuvendit të Kosovës bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës

Pyetja: Pse po ndodhin vonesat në kompensimin e mjeteve materiale ndaj ish të burgosurve politik të cilët kishin vuajtur vite të tëra nëpër burgjet e Serbisë?



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

<b>PËR / ZA / TO</b>	z. Pal Lekaj – Ministër i Infrasrtukturës	<b>DATE DATUM DATE</b>	13. 07. 2018
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Ismajl Kurteshi, deputet i Lëvizjes VETËVENDOSJE!		<i>I. Kurteshi</i>
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

**Në bazë të Rregullës 45 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.**

**ÇËSHTJA: Sinjalizimi horizontal i rrugëve**


Pjesës më të madhe të rrugëve magjistrale në Kosovë ju mungon sinjalizimi horizontal (vijat e bardha në mes të rrugës dhe vijat anësore), shumë sinjale vertikale dëmtohen ose largohen nga vendi ku janë vendosur. Edhe kur rrugët sinjalizohen materiali sinjalizues është shumë i dobët.

Mungesa e sinjalizimit sigurisht është njëri nga faktorët e rëndësishme që ndikon në rritjen e numrit të aksidenteve në trafik. Kohëve të fundit është raportuar se mjetet e parapara për sinjalizim janë ri destinuar për pagesën e anëtarësimit të Kosovës në një organizatë ndërkombëtare.

**PYETJE PARLAMENTARE**

z. Ministër,

Kur do t'i pajisni rrugët me sinjalet e nevojshme sidomos atyre horizontale?



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

<b>PËR / ZA / TO</b>	z. Shyqiri Bytyqi – Ministër i MASHT-it	<b>DATË DATU M DATE</b>	13. 07. 2018
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Ismajl Kurteshi, deputet i Lëvizjes VETËVENDOSJE!		<i>I. Kurteshi</i>
<b>SUBJE KTI PREDM ET SUBJE CT</b>	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

Në bazë të Rregullës 45 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

**ÇËSHTJA: Koordinatorët e Cilësisë**


Në vitin e fundit shkollor në shkollat fillore dhe të mesme në tërë vendin janë angazhuar një numër i konsiderueshëm i koordinatorëve të cilësisë.

**PYETJE PARLAMENTARE**

z. Ministër,

Sa koordinator të cilësisë janë aktualisht të angazhuar? Cila është puna e tyre konkrete në shkollë?

A janë vërejtur efektet e angazhimit të koordinatorëve të cilësisë në ngritjen e cilësisë në arsim?



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

<b>PËR / ZA / TO</b>	z.Bedri Hamza – Ministër i Financave	<b>DATE DATUM DATE</b>	16. 07. 2018
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Arbër Rexhaj, deputet i Lëvizjes VETËVENDOSJE!		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

Në bazë të Rregullës 45 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

### ÇËSHTJA

Sipas udhëzimit administrativ për pagat, shtesat dhe shpërblimet e zbatueshme në doganën e Kosovës me numër nr. 01/442/2016 të datës 19.01.2016 parashihen që të jipen tre(3) paga të fundit.


### PYETJE PARLAMENTARE

z. Ministër,

Sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës, ligjit të punës 03/L-212 dhe nenit 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës ku i punësuari me rastin e pensionimit gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi për tri (3) paga mujore bruto.

Në doganën e Kosovës veprohet në mënyrë selektive, dikush merr një(1) pagë të fundit dhe dikush tre (3). Pse ndodh ky selektim?





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

<b>PËR / ZA / TO</b>	z. Skender Reçica - Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale	<b>DATE DATUM DATE</b>	16. 07. 2018
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Arbër Rexhaj, deputet i Lëvizjes VETËVENDOSJE!		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

Në bazë të Rregullës 45 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

**ÇËSHTJA**

Skema pensionale për punëtorët e viteve 1991-1999

**PYETJE PARLAMENTARE**

z. Ministër,

A jeni në dijeni që në skemën pensionale për qytetarët e Republikës padrejtësisht nuk njihet përvoja e punës për periudhën 1991-1999, atëherë kur shteti serb largonte punëtorët dhunshëm nga puna? Pse nuk u njihet përvoja e punës qytetarëve të larguar nga puna gjatë viteve 1991-1999?